



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSCO

Numri i lëndës: 2018:030840

Datë: 26.06.2018

Numri i dokumentit: 00071346

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
DHE I Detyrues
REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

11. 01. 2019

P.nr.137/13



NË ËMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, si gjykatë e shkallës së parë penale, e përbërë nga gjyqtari individual, Adem Shabani me procesmbajtësen Marigona Shaqiri, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED], nga Ferizaj rruga " [REDACTED]" numër [REDACTED], për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nën par 1 të KPPK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike Komunale në Ferizaj PP.nr.803/2009 dt. 07.10.2009, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar - gjyqësor publik, në prezencën e prokurorit të shtetit Bahri Hyseni, të pandehurit [REDACTED] me dt.26.06.2018 mori dhe shpalli të njëjtën ditë publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri pandehurit [REDACTED], nga Ferizaj rruga " [REDACTED]" numër [REDACTED], lindur më [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED] shqiptare, shtetasi Republikës së Kosovës e pa martuar, ka të kryer shkollën fillore është, në vuajtje të dënimit i gjykuar për një veprë tjetër në Qendrën e Paraburgimit në Dubravës dhe në gjykatë është sjellë në bazë të urdhëresë së gjykatës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 05.12.2008 rreth orës 21:00, në Ferizaj në rrugën " Tahir Sinani ", prapa Raffaisen Bankës i pandehuri, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshëm e që vetit t i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, duke përdor forcën e ka thyer xhamin e parë të anës së djathtë të automjetit " Opel Vectra " me targë të regjistrimit [REDACTED] i cili automjet ishte pronë e të dëmtuarit [REDACTED] dhe nga aty kishte marrë kasetofonin e

automjetit CD të markës JVC me ngjyrë hiri ka vlera e dëmit të shkaktuar sipas të dëmtuarit sillet rreth 150 Euro si dhe të njëjtën ditë i pandehuri i pandehuri kasetofonin ia kishte shitur një personi nga Fushë Kosova.

- me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nën par 1 të KPPK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitë së larte cituar dhe dispozitave të nen. 3, 34, 36,38,64,66 dhe 67 të KPK-së e :

G J Y K O N

Të pandehurit [REDAKTUAR] i shqipton dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/tre/ muajve të cilin dënim i akuzuari do ta mbaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga " [REDAKTUAR] ", për realizimin e kërkesës pasurore-juridike u udhëzuan në kontest civil.

Obligohet e pandehura që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.803/2009 dt. 07.10.2009, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR], nga Ferizaj rruga " [REDAKTUAR] " numër [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nën par 1 të KPPK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 26.06.2018 , me pjesëmarrjen e prokurorit të shtetit Bahri Hyseni dhe të akuzuarit i cili është sjellë në shqyrtimin fillestar sipas urdhëresë së gjykatës nga Qendra e Paraburgimit në Dubravës pasi i pandehuri është në vuajtje të dënimi për një vepër tjetër penale.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i pandehuri është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të pandehurit janë përfill, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën të pandehurit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi , të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I pandehuri [REDAKTUAR] ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar si në dispozitiv të akuzës edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë nga kryerja e kësaj vepre penale, por pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit dhe sqarimet nga gjyqtari gjykues, i'u kujtohet se atë ditë kishte përdor alkool dhe nuk ka mundur që ta kontrollon vetën për veprimet e kryera është penduar dhe që nga ajo kohë është i gjykuar për një vepër tjetër penale dhe është në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës dhe këto kanë

qenë arsyet se nuk ka mundur të paraqitet në gjykatë edhe pse u njoftua nga gjykata se në këtë çështje penale janë marruar veprime procedurale, i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të merr për bazë pranimin e fajit dhe se gjendet i privuar nga liria.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, nga i pandehuri në këtë fazë të procedurës penale.

Prokurori i shtetit Bahri Hyseni theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor pasi pranimin e fajësisë e ka mbështetur në provat që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i pandehuri pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale në kallëzimin penal të Stacionin Policor në Ferizaj me nr.2008-CF-2969 të dt.21.04.2009 në deklaratën e të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhenë në polici me dat.22.01.2009 të pandehurit me dt.11.12.2008.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nën par 1 të KPPK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 64 të KPK-së, si rrethana lehtësuese gjykata mori pranimin e fajësisë, pendimin për veprën penale që e ka kryer, koha kur e ka kryer këtë vepër penale kanë kaluar mbi tetë vite, nuk është në liri por në vuajtje të dënimit për një vepër tjetër penale, ku gjykata konform nenit 3 ndaj kryesit ka zbatuar ligjin që ka qenë në fuqi në kohe e kryerjes së veprës penale Neni 3 i KPRK-së në fuqi, bazuar në dispozitat e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së kësaj vepre penale bazuar në nenet 66 dhe 67 të KPK-së të pandehurit i ka zbutur dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është plotësisht i arsyeshëm dhe në proporcion me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetit e të pandehurit, dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari në të ardhmen të mos kryejë vepra penale, si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 34 të KPK-së.

Konform nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së, të dëmtuarin [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga " [REDAKTUAR]", për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Numri i lëndës: 2018:030840
Datë: 26.06.2018
Numri i dokumentit: 00071346

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë konform nen. 450 dhe 451 të KPPK-së, dhe Gjykata e ka obliguar të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P.nr.137/2013 me datë 26.06.2018

Procesmbajtëse
Marigona Shaqiri



Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet, ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.